

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR SHËRBIMET AJRORE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore, e cila ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është i parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Kjo marrëveshje do të ndikojë në krijimin e kushteve të përshtatshme, të ndërsjella dhe lehtësuese, për operatorët e transportit ajror të të dyja vendeve, si dhe kalimin tranzit nëpërmjet territoreve të tyre, me qëllim lëvizjen pa pengesa për shtetasit e të dyja palëve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrimin me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Republika e Shqipërisë, si nënshkruese e Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, më 7 dhjetor 1947 (Konventa e Çikagos) ka detyrime të koordinojë veprimtarinë e saj në fushën e aviacionit civil.

Bashkëpunimi në fushën e transportit ajror konsiston dhe orientohet nga parimi i krijimit të komunikimit ndërmjet vendeve, gjë e cila justifikon dhe iniciativën e nisur për të realizuar këtë marrëveshje, e cila krijon hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Marrëveshja, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore, u përafrua në Tiranë, më 25 – 26 shkurt 2014, në takimin midis përfaqësuesve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Autoritetit të Aviacionit Civil, dhe përfaqësuesve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Mbretërisë së Arabisë Saudite. Kjo marrëveshje u nënshkrua nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Arabisë Saudite, më 6 shkurt 2019, në Riad.

Marrëveshja është e përbërë nga 37 nene dhe shtojca A, pjesë përbërëse e saj.

Në nenin 1 jepen përkufizime të termave të fushës së aviacionit që përdoren në këtë marrëveshje.

Në nenet 2, 3 dhe 4 parashikohen rregullat për dhënien e të drejtave në lidhje me shërbimet ajrore ndërkombëtare të planifikuara, si dhe parashikimet dhe përcaktimet në lidhje me autorizimet e përshtatshme për operim, ndërsa në nenin 5 përcaktohen detyrimet e palëve për aplikimin e tarifave të njëjta të shfrytëzimit për linja ajrore të përcaktuara.

Në pikën 1, të nenit 6, përcaktohet se çdo palë, në bazë të reciprocitetit, do të përjashtojë një linjë ajrore të përcaktuar të palës tjetër, në masën më të plotë të mundur në bazë të ligjit të tij të brendshëm, nga detyrimet doganore, taksat, tarifat e inspektimit dhe detyrimeve të tjera kombëtare, si dhe listohen artikujt që përfitojnë këtë trajtim lidhur me funksionimin ose shërbimin e avionit të linjës ajrore të përcaktuar të palës tjetër që kryen shërbimet e miratuara. Në pikën 2, të nenit 6, jepen aplikimet e përjashtimeve të dhëna në paragrafin 1, edhe për rastet brenda territorit të aeroportit, kur përdoren për pjesën e mbetur të udhëtimit.

Në nenet 7 deri 10, marrëveshja vendos një kuadër rregullash dhe procedurash për funksionimin e shërbimeve, për transportin ndërkombëtar ajror të udhëtarëve, mallrave dhe postës, si dhe përcakton të drejtat e transportuesve të

të dyja palëve në transportin ajror. Marrëveshja, gjithashtu, vendos rregullat dhe parimet dhe siguron një zhvillim të koordinuar dhe liberalizimin progresiv të transportit ndërmjet palëve, të mbështetur në nevojat reciproke komerciale dhe kushtet e hyrjes në tregun e transportit ajror.

Në nenin 11 marrëveshja parashikon se transferimi i të ardhurave nga linja/linjat ajrore të përcaktuar/a të palëve kontraktuese do të jetë në përputhje me rregullat e kursit të këmbimit të huaj valutor të palës në territorin e së cilës llogariten të ardhurat në lidhje me transportin e pasagjerëve, postës dhe ngarkesave dhe do të zbatohen tarifat bankare normale. Linja/linjat ajrore të përcaktuar/a të palëve kontraktuese janë të tatueshme në shtetin kontraktues në të cilin ndodhet vendi i menaxhimit efektiv të tyre.

Në nenin 12 jepen dispozita lidhur me njohjen e ndërsjellë të certifikatave të vlefshmërisë për fluturim, certifikatat e kompetencës dhe licencat e lëshuara ose të bëra të vlefshme nga njëra palë dhe që janë ende në fuqi.

Në nenet 13 dhe 14, në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e secilës palë, sipas së drejtës ndërkombëtare, nëpërmjet marrëveshjes riafirmohet detyrimi ndaj njëra – tjetrës për të mbrojtur sigurinë e aviacionit civil ndaj akteve të ndërhyrjeve të paligjshme, në përputhje me konventat ndërkombëtare për këtë qëllim dhe, veçanërisht, në pajtim me dispozitat e sigurisë së aviacionit që janë vendosur nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.

Në nenin 17 parashikohen dispozita lidhur me konsultimin dhe ndryshimin e marrëveshjes. Ndryshimet që mund të pësojë marrëveshja do të hyjnë në fuqi me shkëmbim të notave diplomatike, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore.

Në nenet në vijim jepen parashikimet e kësaj marrëveshjeje në lidhje me garantimin e zbatueshmërisë së legjislacionit vendas gjatë qëndrimit në territorin përkatës, si dhe rregullat në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve të mundshme.

Në nenin 37 parashikohet se marrëveshja miratohet dhe hyn në fuqi ditën e shkëmbimit të notave diplomatike nga palët kontraktuese, ku secila nga palët njofton njëra-tjetrën se kanë përfunduar procedurat e tyre të brendshme ligjore, për hyrjen në fuqi të saj.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në përputhje me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.5, datë 9.1.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar në Riad më 6 shkurt 2019.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk përmban efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, për zbatimin e tij.

KËSHILLI I MINISTRAVE